



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË**
 MINISTRI

Nr. *12611* Prot.

Tiranë, *11* 12 2017

URDHËR

Nr. *627*, datë *11.12.2017*

PËR

"NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE ZHVILLIMIN E BISEDIMEVE PËR LIDHJEN E KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS NË DEGËN E MËSUESISË"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159-163 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. nr. 505, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë".

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës në degën e mësuesisë, me përbërje si më poshtë:

a) Z. Koli Bele	Kryetar;
b) Z. Alqi Kushi	Anëtar;
c) Znj. Zamira Gjini	Anëtar;
d) Znj. Mirela Bimo	Anëtar;
e) Znj. Denisa Veliu	Anëtar;
f) Z. Arben Beqiri	Anëtar;
2. Grupi i punës do të asistohet nga sekretariati teknik me përbërje si më poshtë:
 - a) Z. Embri Kollçinaku
 - b) Z. Dritan Salaku
3. Grupi i punës ka për detyrë:
 - a) Të administrojë dhe shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin e palëve të interesuara përfaqësues të punëmarrësve;
 - b) Të zhvillojë bisedimet me këto palë për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës në degën e mësuesisë;
 - c) Të propozojë pranë Ministrit draft kontratën Kolektive të Punës në degën e mësuesisë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Grupi i Punës dhe të gjitha palët e interesuara përfaqësues të punëmarrësve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA
 MINISTËR



Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 23, AL 1001, Tiranë
 Tel: +355 4 2222260

Email: info@arsimi.gov.al
 Web site: www.arsimi.gov.al